Shuma	- " -	35	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003

5. Pistoletë trofe "Parabel"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë vit	Copë	110	30 copë të mbahen si objekt i ligjit nr.9048

6. Pistoletë trofe "Valter"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë vit	Copë	87	30 copë të mbahen si objekt i ligjit nr.9048

7. Pistoletë trofe "Mauzer"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë vit	Copë	6	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003

8. Pushkë trofe italiane

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
1808	Copë	1	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003
1894	- " -	2	- " - " " - " "
1895	- " -	1	- " - " " - " "
1896	- " -	1	- " - " " - " "
1897	- " -	1	- " - " " - " "
1898	- " -	1	- " - " " - " "
1900	- " -	3	- " - " " - " "
1901	- " -	1	- " - " " - " "
1902	- " -	1	- " - " " - " "
1904	- " -	1	- " - " " - " "
1912	- " -	2	- " - " " - " "
1914	- " -	3	- " - " " - " "
1915	- " -	7	- " - " " - " "
1916	- " -	6	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003
1917	- " -	9	- " - " " - " "
1918	- " -	23	- " - " " - " "
1919	- " -	3	- " - " " - " "
1929	- " -	2	- " - " " - " "
1932	- " -	2	- " - " " - " "
1933	- " -	2	- " - " " - " "
1934	- " -	1	- " - " " - " "
1935	- " -	10	- " - " " - " "
1936	- " -	14	- " - " " - " "
1937	- " -	7	- " - " " - " "
1938	- " -	6	- " - " " - " "
1940	- " -	253	20 copë të mbahen si objekt i ligjit nr.9048
1941	- " -	81	- " - " " - " "
1942	- " -	43	- " - " " - " "
Shuma	- " -	487	
Nuk kanë vit Prodhimi	- " -	42	Nuk janë objekt i ligjit nr. 9048.
Shuma gjithsej	- " -	529	170 copë janë objekt i ligjit nr.9048 dhe 359 copë nuk janë objekt i këtij ligji

9. Pistoletë trofe "Beretta", italiane, model 34.

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë	Copë	92	30 të mbalhen si objekt i ligjit nr. 9048 dhe 62 nuk janë objekt i këtij ligji

10. Pushkë trofe greke

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
1906	Copë	1	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003
1930	- " -	7	- " - " - " -
Shuma	- " -	8	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003

11. Pushkë trofe angleze

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
1914	Copë	1	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003
1915	- " -	2	- " - " - " -
1916	- " -	3	- " - " - " -
1942	- " -	1	- " - " - " -
Shuma	- " -	7	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003

12. Automatik trofe anglez

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë	Copë	1	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003

13. Pushkë trofe të ndryshme

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
1903	Copë	1	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003
1912	- " -	1	- " - " - " -
1915	- " -	1	- " - " - " -
1943	- " -	1	- " - " - " -
Shuma	- " -	4	Objekt i ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003

14. Pushkë trofe arabe

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë	Copë	1	Objekt i ligjit nr. 90-48, datë 07.04.2003

15. Pushkë trofe amerikane të ndryshme

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë	Copë	3	Objekt i ligjit nr. 90-48, datë 07.04.2003

16. Pistoleta trofe të ndryshme

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë	Copë	65	30 të mbahen si objekt i ligjit nr. 90-48 dhe 35 nuk janë objekt i këtij ligji.

17. Pistoletë trofe "Glllok"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë	Copë	2	Objekt i ligjit nr. 90-48, datë 07.04.2003

18. Pistoletë trofe "Broving" Belge

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
Nuk kanë	Copë	2	Objekt i ligjit nr. 90-48, datë 07.04.2003

19. Revolver trofe të ndryshëm

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia	Vërejtje
1926	Copë	1	Objekt i ligjit nr. 90-48, datë 07.04.2003
Nuk kanë	- " -	42	20 të mbahen si objekt i ligjit nr. 90-48, datë 07.04.2003
Shuma	- " -	43	21 të mbahen si objekt i ligjit nr.90-48 dhe 22 nuk janë objekt i këtij ligji

Lista nr.2

Armë të cilat janë objekt i ligjit nr.9048 date 07.01.2003 "Për Trashëgiminë kulturore"

I. Pushkë trofe gjermane

<i>Viti i Prodhimit</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Sasia</i>
1901	Copë	1
1902	- " -	3
1903	- " -	3
1904	- " -	3
1905	- " -	5
1906	- " -	8
1907	- " -	9
1908	- " -	3
1909	- " -	5
1910	- " -	4
1911	- " -	6
1912	- " -	2
1913	- " -	3
1914	- " -	6
1915	- " -	43
1916	- " -	105
1917	- " -	139
1918	- " -	70
1920	- " -	6
1924	- " -	3
1925	- " -	6
1926	- " -	1
1927	- " -	3
1928	- " -	1
1929	- " -	2
1930	- " -	48
1931	- " -	2
1932	- " -	3
1933	- " -	10
1934	- " -	16
1935	- " -	2
1936	- " -	104
1937	- " -	236
1938	- " -	265
1939	- " -	30

1940	- " -	30
1941	- " -	30
1942	- " -	30
1943	- " -	30
1944	- " -	30
1945	- " -	30
Shuma	- " -	1336

2. Automatik trofe gjerman

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë vit	Copë	20

3. Mitrалoz trofe gjerman

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë vit	Copë	5

4. Revolver trofe "Nagant"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
1898	Copë	11
1910	- " -	2
1916	- " -	1
Nuk kanë vit	- " -	21
Shuma	- " -	35

4. Pistoletë trofe "Parabel"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë vit	Copë	30

5. Pistoletë trofe "Valter"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë vit	Copë	30

6. Pistoletë trofe "Mauzer"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	6

7. Pushkë trofe italiane

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
1808	Copë	1
1894	- " -	2
1895	- " -	1
1896	- " -	1
1897	- " -	1
1898	- " -	1
1900	- " -	3
1901	- " -	1
1902	- " -	1
1904	- " -	1
1912	- " -	2
1914	- " -	3
1915	- " -	7
1916	- " -	6
1917	- " -	9
1918	- " -	23
1919	- " -	3
1929	- " -	2
1932	- " -	2
1933	- " -	2
1934	- " -	1
1935	- " -	10
1936	- " -	14
1937	- " -	7
1938	- " -	6
1940	- " -	20
1941	- " -	20
1942	- " -	20
Shuma	- " -	170

8. Pistoletë trofe "Beretta", italiane, model 34.

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	30

9. Pushkë trofe greke

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
1906	Copë	1
1930	- " -	7
Shuma	- " -	8

10. Pushkë trofe angleze

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
1914	Copë	1
1915	- " -	2
1916	- " -	3
1942	- " -	1
Shuma	- " -	7

11. Automatik trofe anglez

Viti i Prodhimit ²	Njësia e matjes	Sasia
Nuk ka	Copë	1

12. Pushkë trofe të ndryshme

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
1903	Copë	1
1912	- " -	1
1915	- " -	1
1943	- " -	1
Shuma	- " -	4

13. Pushkë trofe arabe

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	1

14. Pushkë trofe amerikane të ndryshme

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	3

15. Pistoleta trofe të ndryshme

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	30

16. Pistoletë trofe "Glllok"

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	2

17. Pistoletë trofe "Broving" Belge

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	2

18. Revolver trofe të ndryshëm

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
1926	Copë	1
Nuk kanë	- " -	20
Shuma	- " -	21

Lista nr.3

Armë të cilat nuk janë objekt i ligjit nr.9048 date 07.04.2003 "Për Trashëgiminë kulturore"

1. Pushkë trofe gjermane

<i>Viti i Prodhimit</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Sasia</i>
1939	Copë	297
1940	- " -	498
1941	- " -	564
1942	- " -	582
1943	- " -	1059
1944	- " -	963
1945	- " -	206
Nuk kanë vit prodhimi	- " -	1007
Shuma	- " -	5176

2. Pistoletë trofe "Parabel"

<i>Viti i Prodhimit</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Sasia</i>
Nuk kanë vit	Copë	80

3. Pistoletë trofe "Valter"

<i>Viti i Prodhimit</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Sasia</i>
Nuk kanë vit	Copë	57

4. Pushkë trofe italiane

<i>Viti i Prodhimit</i>	<i>Njësia e matjes</i>	<i>Sasia</i>
1940	- " -	233
1941	- " -	61
1942	- " -	23
Nuk kanë vit prodhimi	- " -	42
Shuma	- " -	359

5. Pistoletë trofe "Beretta", italiane, model 34.

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	62

6. Pistoleta trofe të ndryshme

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	35

7. Revolver trofe të ndryshëm

Viti i Prodhimit	Njësia e matjes	Sasia
Nuk kanë	Copë	22

VENDIM

Nr.791, datë 26.11.2004

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Lidhja nr.1 “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura” zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lidhja nr.2 “Masa e shtesës për kushte të veçanta pune dhe shërbimi, për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura” zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse tij.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1.Shtesa për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, që e përfitojnë ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura, sipas pikës 4, ka karakter të përkohshëm dhe do të zbatohet deri në datën 31 maj të vitit 2005, periudhë brenda së cilës Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me strukturat përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë, duhet të rishikojë dhe të paraqesë listën e hollësishme të vendeve të punëve të vështira e të dëmshme për shëndetin, në përputhje me kriteret e miratuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Punës dhe i Çështjeve Sociale.”.

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Ushtarakët aktivë, paga e të cilëve, sipas pikave 1, 2, 3 e 4 të vendimit, është më e vogël se paga dhe shtesa mbi pagë, që ka përfituar në çastin e zbatimit të efekteve financiare të këtij vendimi, trajtohen me një shtesë “ruajtje page”, por jo më shumë se 2 vjet, duke filluar nga data 1 janar 2004.

Nga zbatimi i shtesës “ruajtje page” përfitojnë:

a) ushtarakët, që do të jenë në të njëjtin funksion;

b) ushtarakët, të cilëve u ndryshon emërtimi i funksionit, por janë në nivel të njëjtë me funksionin e mëparshëm;

c) ushtarakët, në rastet e emërimit në një funksion më të lartë, kur grada e funksionit është e njëjtë me funksionin e mëparshëm.

Masa e kësaj shtese është e barabartë me diferencën e pagës dhe të shtesave mbi pagë, që ka përfituar ushtaraku, me pagën që përfiton ushtaraku, sipas pikave 1, 2 e 3 të këtij vendimi. Në llogaritjen e kësaj mase nuk përfshihet shtesa për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin.”.

II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i parashikuar për vitin 2005, për Ministrinë e Mbrojtjes.

III. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.6.2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

PAGA BAZE SIPAS GRADES DHE VITEVE TE SHERBIMIT PER USHTARAKET AKTIVE TE FORCAVE TE ARMATOSURA

[illegible][illegible][illegible][illegible]

Masa e shteses per kushte te vecanta pune e sherbimi qe perfitojne ushtaraket aktive ne Forcat e Armatosura

Nr.	Personeli ushtarak qe perfiton shtese per kushte te vecanta pune e sherbimi	Masa e shteses (ne leke)
1	Mjeket qe sherbejne ne Forcat e Armatosura Pilotet e emeruar ne pozicione organike qe kerkojne kryerjen e fluturimeve. Parashutistet. Oficeret apo nenoficeret ne detyre dhe ne kualifikim si zhytesa. Oficeret nenoficeret apo ushtaret profesioniste te kualifikuar, qe sherbejne ne njesite Asgjesimit me Eksploziv te Municioneve dhe qe kryejne operacione per shkaterrimin e municioneve dhe eksploziveve. Oficeret nenoficeret apo ushtaret profesioniste te emeruar ne Batalionin Special, te cilet kryejne detyra taktike te Batalionit Special. Oficeret nenoficeret apo ushtaret profesioniste te emeruar ne Regjimentin Komando, qe kryejne detyra taktike komando. Personeli ushtarak radiozbulues i Qendres se Radiozbulimit qe sherben ne repartet Kroj Bardhe-Kukes, Tarabosh -Shkoder, Çardhak-Korce dhe Mali i Krujes	8000
2	Personeli ushtarak administrativ dhe ai ndihmes te cilet jane emeruar ne Batalionin Special, por nuk kryejne detyra taktike te Batalionit Special. Personeli ushtarak administrativ dhe ai ndihmes te cilet jane emeruar ne Regjimentin Komando, por nuk kryejne detyra taktike Komando. Oficeret, nenoficeret apo ushtaret profesioniste ne Brigaden e Stervitjes qe jane emeruar ne funksione dhe kryejne direkt stervitjen baze. Personeli ushtarak i Brigades Stervitjes Bunavi deri ne nivel Kompanie. Personeli ushtarak ne strukturen e Rojes Bregdetare. Personeli tjeter ushtarak i Qendres se Radiozbulimit qe sherben ne repartet Kroj Bardhe-Kukes, Tarabosh -Shkoder, Çardhak-Korce dhe Mali i Krujes. Personeli ushtarak i Batalionit te Policise Ushtarake i cili angazhohet direkt ne punen operative dhe funksionale qe kryen Policia Ushtarake Personeli ushtarak deri ne nivel kompanie ne Brigaden e Reagimit te Shpejte. Komandantet e batalioneve ne Brigaden e Reagimit te Shpejte. Personeli nenoficer dhe ushtar profesioniste operatore radiozbulues ne strukturat e Qendres se Radiozbulimit.	5000

Nr.	Personeli ushtarak qe perfiton shtese per kushte te vecanta pune e sherbimi	Masa e shteses (ne leke)
3	Pilotet e emeruar ne pozicione organike qe nuk kerkojne kryerjen e fluturimeve. Personeli mirembajtes inxhinjero teknik i aviacionit. Personeli fluturues teknik e mekanik.	3000
	Oficeret me specialitete detare te emeruar ne pozicione organike qe kerkojne kryerjen e lundrimeve dhe personeli ushtarak (oficer, nenoficer dhe ushtar profesioniste) i emeruar ne anije.	
	Personeli ushtarak i Batalionit te Policise Ushtarake qe nuk perfshihet ne numrin rendor 2	
	Personeli i Brigades se Reagimit te Shpejte qe nuk perfshihet ne numrin rendor 2	
	Personeli ushtarak (drejtimi dhe trupa) ne Orkestren Frymore.	
	Personeli ushtarak i Brigades Stervitjes Bunavi qe nuk perfshihet ne numrin rendor 2.	
	Personeli ushtarak i kompanise se rikonicionit te Forcave Tokesore. Personeli ushtarak i qendrave te vezhgimit ajror ne Forcat Ajrore. Personeli ushtarak i postave radioteknike dhe postave sinjal vrojtuese ne Forcat Detare.	
	Personeli ushtarak radiozbulues i Qendres se Radiozbulimit qe sherben ne strukturat Shtoj, Kruje, Korce, Kavaje, Sarande te Qendres se Radiozbulimit.	

VENDIM

Nr.792, datë 26.11.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË DIVJAKËS TË PRONAVE ME NUMRAT RENDORË 869, 870, 871, 872 DHE 873, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pronat me numrat rendorë 869 “Batalioni i këmbësorisë”, 870 “Bateri AKA”, 871 “Ish-batalion mitralier”, 872 “Ish-depo municioni” dhe 873 “Ish-poligon qitjeje me aviacion dhe artileri” në Divjakë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’i kalojnë në pronësi bashkisë së Divjakës, për t’i përdorur për menaxhimin e Parkut Kombëtar dhe të zonës së mbrojtur të ekosistemit të Divjakës.

2. Ministrisë së Mbrojtjes, nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, t’i hiqen pronat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Bashkisë së Divjakës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, t'i tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Divjakës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.52, datë 18.11.2004

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA SHOQËRIA “WTS-ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b dhe neni 26, Bordi Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “WTS-ENERGJI” sh.p.k. për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për HEC-in Tamarë dhe relacionin e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve, mbi bazën e një analize të hollësishme të kostos

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria “WTS-ENERGJI” sh.p.k. për HEC-in Tamarë, për periudhën 1.10.2004 – 30.9.2005, të jetë 4,55 /kWh.
2. Ngarkohet shoqëria “WTS-ENERGJI” sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

VENDIM

Nr.53, datë 23.11.2004

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË KESH SHA

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 13 pika 1, nenit 15 të ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” me të gjitha ndryshimet përkatëse, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë”, pika 3 dhe pika 4 vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.11.2004, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga “KESH” sh.a. për marrje licence për aktivitetin e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme nuk janë plotësuar kushtet si më poshtë:

I. Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1, ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me të gjitha ndryshimet përkatëse, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i

Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë pika 3 dhe urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH”, Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 2 dhe pika 3:

- i) ndarjen e plotë të llogarive financiare,
- ii) raportin e ekspertit kontabël, si dhe transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga “KESH” sh.a. për “OST” sh.a.

II. Në zbatim të rregullores për procedurat e licencimit neni 10 germa c, pika 3, pika 5 dhe neni 11 pika 1 paragrafi 8, paragrafi 9, paragrafi 10 , dhe neni 11 pika 3:

i) lidhjen e një kontrate sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimit për aktivitetin e prodhimit dhe të shpërndarjes;

ii) vërtetimin për mbështetje financiare nga institucionet financiare brenda dhe jashtë vendit;

iii) vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis të aseteve prodhuese, në nivel lokal dhe kombëtar;

iv) vlerësimin e përafërt të investimeve të kërkuara;

v) strukturën e kapitalit që do të përdoret për investime dhe burimet e financimit të shprehura në vlerë monetare;

vi) marrëveshjen paraprake për sigurinë e furnizimit me lëndë djegëse të TEC-it Fier;

vii) planin e investimeve për zgjerimin e rrjetit shpërndarës për vitin 2005;

viii) planin e investimeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit shpërndarës për vitin 2005.

Në bazë të konstatimeve të përmendura më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

I. Dhënie e licencës shoqërisë “KESH” sh.a. për:

i) prodhimin e energjisë elektrike me një afat kohor deri në datën 31.12.2005;

ii) shpërndarjen e energjisë elektrike me një afat kohor deri në datën 31.12.2005.

II. Kjo licencë jepet me kusht. Shoqëria KESH sh.a, brenda afatit 31.12.2005, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

i) Ndarjen e plotë të llogarive financiare në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1;

ii) Raportin e ekspertit kontabël në zbatim të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Per shoqëritë tregtare”, me të gjitha ndryshimet përkatëse, neni 251, 256 dhe urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 3;

iii) Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga “KESH” sh.a. për “OST” sh.a. në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë” pika 4, urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 2;

iv) Lidhjen e një kontrate sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimit për aktivitetin e prodhimit dhe shpërndarjes në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 10 germa c pika 3;

v) Vërtetimin për mbështetje financiare nga institucionet financiare brenda dhe jashtë vendit në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 10 germa c pika 5;

vi) Vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis në nivel lokal dhe kombëtar të aseteve prodhuese në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1;

vii) Vlerësimin e përafërt të investimeve të kërkuara në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1;

viii) Strukturën e kapitalit që do të përdoret për investime dhe burimet e financimit të shprehura në vlerë monetare në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1;

ix) Marrëveshjen paraprake për sigurinë e furnizimit me lëndë djegëse të TEC-it, Fier në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 1;

x) Planin e investimeve për zgjerimin e rrjetit shpërndarës për vitin 2005 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 3;

xi) Planin e investimeve për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit shpërndarës për vitin 2005 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 3;

xii) Pasqyrimin në statutin e shoqërisë “KESH” sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH”, Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”;

xiii) Përcaktimin e faktorëve të humbjeve të energjisë në rrjetin shpërndarës për çdo nivel tensioni në përputhje me aneksin B të licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM

Nr.54, datë 23.11. 2004

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TRANSMETIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT” SHA TIRANË

Në mbështetje të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, neni 13 pika 1, neni 15 ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me të gjitha ndryshimet përkatëse, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i sistemit të transmetimit” sh.a. Tiranë”, pika 3 dhe pika 4, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 23.11.2004 mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “OST” sh.a. për marrje licence për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme nuk janë plotësuar kushtet si më poshtë:

I. Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1, ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, me të gjitha ndryshimet përkatëse, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë, pika 3, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” ndarjen e plotë të llogarive financiare nga “KESH” sh.a., si dhe raportin e ekspertit kontabël.

II. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë pika 4, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga “KESH” sh.a për “OST” sh.a.

III. Në zbatim të rregullores për procedurat e licencimit neni 10 germa c pika 3, neni 11 pika 2 paragrafi 3:

i) lidhjen e një kontrate sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimit për aktivitetin e transmetimit;

ii) realizimin e matjes në kufijtë e funksioneve të prodhimit dhe shpërndarjes.

Në bazë të konstatimeve të përmendura më sipër Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike

VENDOSI:

I. Dhënien e licencës për transmetimin e energjisë elektrike shoqërisë: “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. Tiranë me një afat kohor deri më datë 31.12.2005.

II. Kjo licencë jepet me kusht. Shoqëria “OST” sh.a., brenda datës 31.12.2005, të plotësojë kushtet e mëposhtme:

i) Ndarjen e plotë të llogarive financiare nga “KESH” sh.a. në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për Sektorin e energjisë elektrike” neni 33 pika 1;

ii) Hartimin dhe paraqitjen e raportit të ekspertit kontabël në ERE në zbatim të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” neni 251, 256 dhe urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 3;

iii) Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit nga “KESH” sh.a. për “OST” sh.a. në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a Tiranë” pika 4, urdhrin të Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit” pika 2;

iv) Lidhjen e një kontrate sigurimi me një nga shoqëritë e sigurimit për aktivitetin e transmetimit në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 10 germa c pika 3;

v) Realizimin e matjes në kufijtë e funksioneve të prodhimit dhe shpërndarjes në përputhje me “Rregulloren për procedurat e licencimit” neni 11 pika 2 paragrafi 3;

vi) Pasqyrimin në statutin e shoqërisë “OST” sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63 datë 18.3.2004 “Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. “KESH” Tiranë” dhe krijimin e shoqërisë së re “Operatori i Sistemit të Transmetimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

VENDIM

Nr.55, datë 2.12. 2004

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA “ KESH” SHA PËR KONSUMATORËT FUNDORË PËR VITIN 2005

Në mbështetje të ligjit nr.9072 datë 22.5.2003 “Për Sektorin e energjisë elektrike”, neni 8 pika 2 germa b, neni 26 dhe neni 29 të rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s”, si dhe të procedurave të vendosjes dhe rishikimit të çmimeve në kompanitë e licencuara, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga shoqëria KESH-sh.a. për rishikimin e çmimeve të shitjes të energjisë elektrike për vitin 2005 dhe relacionin e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga shoqëria “KESH” sh.a. për konsumatorët fundorë për vitin 2005 të jenë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet shoqëria KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me 1 janar 2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S

Pjetër Dema

**ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË APROVUARA NGA ERE
PËR VITIN 2005**

Niveli i tensionit	Kategoritë e konsumatorëve	Cmimi ne leke/kWh
TL	Buxhetorë	8.30
	Jobuxhetorë-Ujësjiellës	6.00
	Jobuxhetorë të tjerë	8.30
	Privatë	8.30
	Media	8.30
	Çmimi mesatar në tension të lartë	8.30
TM	Buxhetorë	9.40
	Jobuxhetorë - Ujësjiellës	7.00
	Jobuxhetorë (nafta, kromi, bakri, plehra kimike, çimento, siderurgji)	8.60
	Jobuxhetorë furnizuar nga TM, matja në TM	10.50
	Jobuxhetorë furnizuar nga TM, matja në TU	11.00
	Privatë të favorizuar-furra buke, prodhime mielli, stacione pompimi vaditje	7.00
	Objekte kulti	7.00
	Media	9.00
	Privatë furnizuar nga TM, matja në TM	10.00
	Privatë furnizuar nga TM, matja në TU	10.50
	Çmimi mesatar në tension të mesëm	8.62
TU	Buxhetorë	10.00
	Jobuxhetorë-Ujësjiellës	7.50
	Jobuxhetorë (nafta, kromi, bakri, plehra kimike, çimento, siderurgji)	9.50
	Jobuxhetorë furnizuar nga rrjeti TU	12.00
	Privatë të favorizuar-furra buke, prodhime mielli, stacione pompimi vaditje	7.50
	Objekte kulti	8.00
	Privatë të zakonshëm	12.00
	Media	9.50
	Konsumatorët familjarë	5.95
	(b) Me sasi të faturuar deri në 210 kWh në muaj	4.50
	(e) Me sasi të faturuar mbi 210 kWh në muaj	9.00
	Çmimi mesatar në tension të ulët	6.62
	Çmimi mesatar i energjisë elektrike për KESH-in	7.01

Shënim: Energjia e përdorur për ambientet e përbashkëta (ndriçim shkallë, ashensor, pompë uji) do të faturohen me çmimin prej 4.5 lekë/kWh.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit shpall kërkesën “Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private (tokë-arë) për ndërtimin e dy rezervuarëve të ujit të pijshëm në kuadër të projektit për zonën rurale të qytetit të Durrësit”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është sh.a. Ujësjellës-kanalizime, Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vemë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, për secilin person, sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë me periudhë njëjavore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit).

PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I REZERVUARIT TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATIN KATUND I RI

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë arë	Çmimi tokës/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)
1	Z.Vath Çurbja	1400 m ²	1150	1 610 000
2	Z.Hysen Çyrbja	200 m ²	1150	230 000
		Totali/lekë		1 840 00

PRONARI QË DO TË SHPRONËSOHET NGA NDËRTIMI I REZERVUARIT TË UJIT TË PIJSHËM NË FSHATIN MANËZ TË BASHKISË MANËZ

Nr	Emri, mbiemri	Sip/tokë arë	Çmimi objektit/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)
1	Qamil Kurti	1075	1000	1 075 000

Vlera totale e shpronësimit është 2 915 000 (dy milionë e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
16.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
15.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
16.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 14.12.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë